



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA

Versioni 1.0

Nr. Ref: ASHNA/REG/01-2019

Data e Ver.: 31.12.2018

	REPUBLIKA E KOSOVES RE PUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR AGENCIJA ZA VAZDUSNO NAVIGACIJSKE USLUGE AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY
ZYRA E ARKIVES KANČERARSKA ARHIVA ARCHIVES OFFICE		
Nr. fac. Br. št. Pg. no.	Data Datum Date 31.12.2018	
Nr. prot. Br. prot. Prot. no.	0679 N.T. LIPJAN, RKS	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Hyrje

Kjo Rregullore është pronë e:

Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror
10070 Vrellë, Lipjan
Republika e Kosovës

Prona intelektuale e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) mbrohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Çdo kopjim ose riprodhim i këtij materiali pa lejen me shkrim të publikuesit është i ndaluar.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë procesit të rregulluar të shpërndarjes ose trajnimeve të brendshme të ASHNA-së do të konsiderohet si shkelje e procedurave të ASHNA-së dhe në kundërshtim me ligjin.

Bahri Nuredini

Drejtor



Njësia Organizative: ASHNA
Nr. Ref./Kodi: ASHNA/REG/01-2019
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 31.12.2018

Faqe 2 nga 157



Aprovimi

	Emri / Pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Kujtim Demiri, Menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore	31/12/2018	
Kontrolli i Cilësisë nga:	Petrit Murtezaj, Udhëheqës i Divizionit për Cilësi dhe Përputhshmëri	31.12.2018	
Aprovuar nga:	Bahri Nuredini, Drejtor	31.12.2018	

Regjistrimi i ndryshimeve

Versioni-revidimi	Data e revidimit	Faqet e afektuara	Vërejtje
			Efektive nga 01.01.2019

Lista e shpërndarjes

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
1	Libraria e ZYDR	E shtypur	1
2	Libraria e DBNJ	E shtypur	1
3	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (SMD)	Elektronike	1
4	Arkivi i ASHNA-së	E shtypur	1
5	Ministria e Infrastrukturës, RKS (MI)	E shtypur	1
6	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AACK)	E shtypur	1
7	Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, MAP (DASHC)	E shtypur	1





Lista e faqeve efektive

Kapitulli	Faqet	Nr. i revidimit	Data e hyrje
Hyrje	2/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Aprovimi/Regjistrimi i Ndryshimeve/Lista e shpërndarjes	3/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Lista e faqeve efektive / Shkurtesat	4/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Shkurtesat	5/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Përmbajtja	6/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Qëllimi		Versioni 1.0	01.01.2019
Fushëveprimi	7/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Baza ligjore	7/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Parimet e organizimit dhe funksionimit të brendshëm	7/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Kompetencat dhe përgjegjësitë e ASHNA-së	8/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Struktura Organizative	9/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Zyra e Drejtorit	10/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamentet dhe Divizionet e ASHNA-së	10/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Familja e vendeve të punës në ASHNA	10/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Skema e gradave	11/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Planifikimi i punës	12/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Raportimi	14/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Buxheti i ASHNA	14/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Titujt e vendeve të punës	15/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Drejtori i ASHNA-së dhe Zyra e Drejtorit	19/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim	31/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti Teknik	42/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim	77/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Prokurimit	82/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Burimeve Njerëzore	86/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Zëvendësdrejtori për shërbime operative	94/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror	99/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	111/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti Meteorologjik	118/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Zëvendësdrejtori për shërbime administrative financiare	128/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Financave	132/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Administratës	141/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Departamenti i Ligjor	153/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Dispozitat kalimtare	157/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Aspektet e punësimit	157/157	Versioni 1.0	01.01.2019
Hyrja në fuqi	157/157	Versioni 1.0	01.01.2019





Shkurtesat

Shkurtesa	Kuptimi
AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
ABR	Auditori i Brendshëm
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
DBNJ	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DCSS	Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
DFIN	Departamenti i Financave
SMD	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (<i>Document Management System</i>)
DZHT	Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
DKNV	Departamenti për Komunikim Navigim Survejim
KCSS	Komiteti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
DKTA	Departamenti Kontrolli i Trafikut Ajror
DMET	Departamenti Meteorologjik
MMC	Manuali për Menaxhimin e Cilësisë
MMS	Manuali për Menaxhimin e Sigurisë
MO	Mirëmbajtja e objekteve
MTA	Menaxhimi i Trafikut Ajror
MVS	Metodologjia për Vlerësim të Sigurisë
PSSA	Vlerësimi Preliminar i Sigurisë së Sistemit
SKR	Skema për Klasifikim të Rrezikut
SMC	Sistemi për Menaxhim të Cilësisë
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
SSA	Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit
SHIA	Shërbimet e Informatave Aeronautike
SHTA	Shërbimet e Trafikut Ajror
TI	Teknologjia Informative
VAR	Vegla për Analizë të Rrezikut
ZYDR	Zyra e Drejtorit
ZVAF	Zëvendës Drejtor për Shërbime Administratë dhe Financa
ZVOP	Zëvendës Drejtor për Shërbime Operative



P.M
190



Përmbajtja

Hyrje.....	2
Aprovimi.....	3
Regjistrimi i ndryshimeve.....	3
Lista e shpërndarjes.....	3
Lista e faqeve efektive.....	4
Shkurtesat.....	5
KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	7
Neni 1 Qëllimi.....	7
Neni 2 Fushëveprimi.....	7
Neni 3 Baza ligjore.....	7
Neni 4 Parimet e organizimit dhe funksionimit të brendshëm.....	7
Neni 5 Kompetencat dhe përgjegjësitë e ASHNA-së.....	8
KREU II ORGANIZIMI I BRENDSHËM.....	9
Neni 6 Struktura Organizative.....	9
Neni 7 Zyra e Drejtorit.....	10
Neni 8 Departamentet dhe Divizionet e ASHNA-së.....	10
Neni 9 Familja e vendeve të punës në ASHNA.....	11
Neni 10 Skema e gradave.....	11
Neni 11 Planifikimi i punës.....	12
Neni 12 Raportimi.....	14
Neni 13 Buxheti i ASHNA.....	15
Neni 14 Titujt e vendeve të punës.....	15
Neni 15 Drejtori i ASHNA-së dhe Zyra e Drejtorit.....	19
Neni 16 Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim.....	31
Neni 17 Departamenti Teknik.....	42
Neni 18 Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim.....	77
Neni 19 Departamenti i Prokurimit.....	82
Neni 20 Departamenti i Burimeve Njerëzore.....	86
Neni 21 Zëvendësdrejtori për shërbime operative.....	94
Neni 22 Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror.....	99
Neni 23 Departamenti i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik.....	111
Neni 24 Departamenti Meteorologjik.....	118
Neni 25 Zëvendësdrejtori për shërbime administrative financiare.....	128
Neni 26 Departamenti i Financave.....	132
Neni 27 Departamenti i Administratës.....	141
Neni 28 Departamenti i Ligjor.....	153
KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE.....	157
Neni 29 Dispozitat kalimtare.....	157
Neni 30 Aspektet e punësimit.....	157
Neni 31 Hyrja në fuqi.....	157





Në zbatim të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28-2014 / 28 Prill 2014), Drejtori miraton aktin nënligjor me të cilin rregullon funksionimin e brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror:

“Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA”

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i “Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA” është organizimi i brendshëm, definimi i njësive organizative, përcaktimi i kritereve për vendet e punës, skemën e gradave, gradat për vendet e punës, përshkrimi i detyrave për vendet e punës, familjet e vendeve të punës në Agjencinë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë të punësuarit dhe njësitë organizative në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 3 Baza ligjore

“Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA” është akt i brendshëm nënligjor i ASHNA-së që derivon nga Ligji Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Neni 4 Parimet e organizimit dhe funksionimit të brendshëm

1. ASHNA përmbush detyrat e saj dhe ushtron aktivitetin e saj institucional në mënyrë të përgjegjshme, me mbarëvajtje efektive profesionale.
2. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i ASHNA-së bazohet në:
 - 2.1 Parimin e ligjshmërisë dhe pavarësisë organizative – nënkupton që ASHNA duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në mënyrë të pavarur organizon funksionimin e brendshëm.
 - 2.2 Parimin e profesionalizimit – nënkupton që ASHNA, në organizimin dhe funksionimin e brendshëm do të bazohet në profesionalizëm dhe se personeli i saj, siguron punë profesionale.
 - 2.3 Parimin e funksionalitetit – nënkupton që ASHNA ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë brenda organizatës në emër organizimit të brendshëm e zhvillon duke siguruar funksionalitet.





- 2.4 Parimin evropian: "Paga e Njëjtë për Punë të Njëjtë" – që do të thotë se punonjësit që kryejnë punë të krahasueshme ose që kanë nivel të ngjashëm të punës, me kualifikimet dhe përvojën e kërkuar për nivelin e pozitës, paguhen njëjtë. Dhe pagë më e lartë për pozitat më të vështira dhe me më shumë përgjegjësi.
- 2.5 Parimi i shpërblimit të personelit të licencuar – që do të thotë se zyrtarët që kanë licencë të lëshuar nga AACK dhe ajo mirëmbahet në baza të përcaktuara nga AACK do të shpërblehen në vartësi të numrit dhe llojit të licencës.
- 2.6 Parimi i ndjekjes së standardit të pagës në industri – që do të thotë se përcaktimi i pagave duhet të shqyrtohet në baza periodike dhe gjatë caktimit të nivelit të pagesës duhet të merret parasysh edhe niveli i pagesës në industrinë e aviacionit. (sipas nenit 24 të Ligjit mbi Aviacionin Civil të Kosovës 03-L051).

Neni 5

Kompetencat dhe përgjegjësitë e ASHNA-së

1. ASHNA duke u bazuar në Nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, përveç nëse parashihet ndryshe me kontratë ose marrëveshje ndërkombëtare do të jetë përgjegjëse për:
 - 1.1 Ofrimin e Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror.
 - 1.2 Menaxhimin e Qarkullimit të Trafikut Ajror dhe të Hapësirës Ajrore (në bashkëpunim me NATO).
 - 1.3 Shërbimet e Informimit Aeronautik.
 - 1.4 Shërbimin Meteorologjik Aeronautik.
 - 1.5 Blerjen, instalimin, mirëmbajtjen, operimin dhe modernizimin e komunikimit, navigacionit, paisjeve dhe sistemeve të vëzhgimit të hapësirës ajrore.
 - 1.6 Prokurimin, instalimin, mirëmbajtjen, operimin, dhe modernizimin e të gjitha pajisjeve përcjellëse të nevojshme të navigacionit (me përjashtim të paisjeve ndihmëse vizuale) dhe furnizuesve primarë dhe të përsëritshëm të energjisë dhe furnizuesve ndihmës. ASHNA dhe operatorët e aeroportit ose kompanitë të cilat menaxhojnë dhe operojnë aeroportet në Republikën e Kosovës do ta kenë Memorandumin e Mirëkuptimit ku deklarohet pronësia, përgjegjësia, mirëmbajtja dhe operimi për paisjet e tilla. Memorandumi i Mirëkuptimit do të rishikohet çdo vit me qëllim të sigurimit të relevancës dhe efektivitetit konstant.
 - 1.7 Ofrimin e trajnimeve dhe këshillave në lidhje me navigacionin ajror.
 - 1.8 Realizimin e hulumtimeve dhe zhvillimeve në lidhje me navigacionin ajror.
 - 1.9 Zhvillimin e metodave për shpejtimin e modernizimit të kontrollit të trafikut ajror dhe përmirësimin e sigurisë së aviacionit lidhur me kontrollin e trafikut ajror.
 - 1.10 Marrëveshjet për zhvillim me Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së dhe me shfrytëzuesit të produkteve, shërbimeve dhe kapaciteteve të cilat i ofron.
 - 1.11 Veprimin në përputhje me standardet e të caktuara nga AAC-ja dhe të reagojë shpejt në gjetjet gjatë mbikëqyrjes nga AAC-ja.
 - 1.12 Konsultim me konsumatorët, udhëtarët përfshirë dhe me shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë siç janë kompanitë ajrore, transportuesit e ngarkesave, prodhuesit, aeroportet, aviacionin e përgjithshëm dhe të përqendrohet në realizimin e rezultateve që i plotësojnë nevojat e konsumatorëve të jashtëm të ASHNA.
 - 1.13 Konsultimin dhe bashkëpunimin me operatorët ose kompanitë të cilat menaxhojnë dhe operojnë aeroportet në Republikën e Kosovës, me AAC-në, Ministrinë dhe NATOn për të përcaktuar praktikatat më të mira për përmirësimin e nevojave të ndryshme në tërë hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.
 - 1.14 Formulimin dhe rekomandimin tek AAC-ja për çdo ndryshim rregullativ të nevojshëm për ASHNA-n në mënyrë që të arrihen qëllimet e performancës dhe të ofrohet siguri në nivel të duhur.
 - 1.15 Ofrimin e këshillave për Qeverinë lidhur me zhvillimin e politikave të propozuara nga Qeveria për përdorimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës që të plotësojë nevojat e shfrytëzuesve duke pasur parasysh sigurinë kombëtare faktorët ekonomik, mjedisin dhe nevojën për një standard të lartë të sigurisë.






- 1.16 Kryen e funksione tjera që kanë të bëjnë me aviacionin civil në Republikën e Kosovës të cilat i janë caktuar me këtë ligj ose me ndonjë akt tjetër normativ.
2. ASHNA koordinon përpjekjet e kërkimit dhe shpëtimit me Ministrinë përkatëse të Punëve të Brendshme dhe bashkëpunon ngushtë me Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.
 3. ASHNA do të sigurojë navigacion ajror të sigurt të vazhdueshëm të qetë dhe efektiv përmes kryerjes së detyrave si ofrues i shërbimit të navigacionit ajror përmes menaxhimit të hapësirës ajrore dhe përmes menaxhimit të qarkullimit të trafikut ajror në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil në fuqi dhe me Rregulloret në bazë të Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

KREU II ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Neni 6 Struktura Organizative

1. Drejtori i ASHNA-së është organi më i lartë i udhëheqjes ekzekutive dhe administrative. Detyrat dhe funksionet e tij ai i ushtron bazuar në Ligjin për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe ligjet tjera në fuqi.
2. Bazuar në nenin 9 të Ligjit mbi Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Drejtori rregullon funksionimin dhe pozitat e personelit në ASHNA, përkatësisht edhe strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara.
3. Drejtori i ASHNA-së, zëvendësdrojtoret, menaxherët e departamenteve dhe udhëheqësit e divizioneve përbëjnë strukturën udhëheqëse të ASHNA-së. Ata janë përgjegjës për veprimtarinë në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre.
4. Struktura Organizative e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është si vijon:



Njësia Organizative: ASHNA
Nr. Ref./Kodi: ASHNA/REG/01-2019
Ver.: 1.0
Data e Ver.: 31.12.2018

Faqe 9 nga 157



5. Në rast të mungesës të Drejtorit, atëherë kompetenca të caktuara mund të barten të Zëvendësdrejtori i shërbimeve operative apo të Zëvendësdrejtori i shërbimeve administrative financiare. Në raste të veçanta dhe mungesës së Zëvendësdrejtorëve, Drejtori mund t'ia delegojë kompetencat e veta edhe ndonjë zyrtari tjetër në ASHNA.
6. Nivelet hierarkike në strukturën organizative të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është si vijon:
 - 2.1 Zyra e Drejtorit
 - 2.2 Zyra e Zëvendësdrejtorit për shërbime operative
 - 2.3 Zyra e Zëvendësdrejtorit për shërbime administrative financiare
 - 2.4 Departamentet
 - 2.5 Divizionet
 - 2.6 Sektorët
 - 2.7 Zyra

Neni 7

Zyra e Drejtorit

1. Zyra e Drejtorit përbëhet nga:
 - 1.1 Drejtori i ASHNA-së
 - 1.2 Njësia e Auditimit të Brendshëm
 - 1.3 Menaxheri i Zyrës së Drejtorit
 - 1.4 Koordinatori për Marrëdhënie me Jashtë
 - 1.5 Këshilltari Ligjor i Aviacionit Civil
 - 1.6 Këshilltari Ekonomiko-Financiar i Aviacionit Civil
 - 1.7 Zyrtari Çertifikues/Aprovues
 - 1.8 Zëdhënësi i ASHNA-së
 - 1.9 Personeli mbështetës
 - 1.9.1 Asistent
 - 1.9.2 Shofer
 - 1.10 Zëvendësdrejtori për shërbime operative
 - 1.10.1 Personeli mbështetës
 - 1.11 Zëvendësdrejtori për shërbime administrative financiare
 - 1.11.1 Personeli mbështetës

Neni 8

Departamentet dhe Divizionet e ASHNA-së

1. Departamentet dhe Divizionet e ASHNA-së janë:
 - 1.1 Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
 - 1.1.1 Divizioni për Cilësi
 - 1.1.2 Divizioni për Siguri
 - 1.1.3 Divizioni për Sigurim
 - 1.2 Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim
 - 1.2.1 Divizioni për Zhvillim
 - 1.2.2 Divizioni për Trajnim
 - 1.3 Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror
 - 1.3.1 Divizioni i Kullës
 - 1.3.2 Divizioni i Vajtje/Ardhje
 - 1.4 Departamenti Teknik





- 1.4.1 Zëvendësmanaxheri për KNV
 - 1.4.1.1 Divizioni i Komunikimit
 - 1.4.1.2 Divizioni i Navigimit
 - 1.4.1.3 Divizioni i Survejimit
 - 1.4.1.4 Punëtorja
- 1.4.2 Zëvendësmanaxheri për Automatikë dhe Mirëmbajtje
 - 1.4.2.1 Divizioni i Procesimit
 - 1.4.2.2 Divizioni i Teknologjisë Informative
 - 1.4.2.3 Divizioni për Mirëmbajtje të Lokacioneve
 - 1.4.2.3.1 Sektori për Rrymë, Klimatizim dhe Gjeneratorë
 - 1.4.2.3.2 Sektori i Mirëmbajtjes
- 1.5 Departamenti i Meteorologjisë
 - 1.5.1 Divizioni i Parashikimit
 - 1.5.2 Divizioni i Vrojtimit
 - 1.5.3 Divizioni për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike
- 1.6 Departamenti i Shërbimeve Informative Aeronautike
 - 1.6.1 Divizioni operativ AIS
 - 1.6.2 Divizioni për Publikimet e Informacioneve Aeronautike
 - 1.6.3 Zyra për Statistika Aeronautike
- 1.7 Departamenti i Burimeve Njerëzore
 - 1.7.1 Sektori i Personelit
 - 1.7.2 Sektori për Siguri dhe Shëndeti në Punë
- 1.8 Departamenti i Financave
- 1.9 Departamenti i Prokurimit
- 1.10 Departamenti i Administratës
 - 1.10.1 Sektori i Pasurisë
 - 1.10.2 Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta (mirëmbajtja, arkiva, transporti, përkthimi)
- 1.11 Departamenti Ligjor

Neni 9

Familja e vendeve të punës në ASHNA

1. Familja e vendeve të punës në ASHNA nënkupton tërësinë e vendeve të punës në nivele të ndryshme hierarkike të cilat i shërbëjnë misionit për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror.
2. Personeli i ASHNA-së përbën një trupë unike dhe i takon Familjes së vendeve të punës "Navigacioni Ajror".

Neni 10

Skema e gradave

- 1 Nivelet e ndryshme të pozitive dhe gradave janë të bazuara në pesë kritere të klasifikimit të pozitive:
 - 1.1 Përgjegjësia – përcakton nivelin e përgjegjësisë së vendit të punës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të institucionit, vendimmarrje, menaxhim të personelit, të buxhetit dhe burimeve tjera.
 - 1.2 Kompleksiteti – përcakton nivelin e ndërlikueshmërisë dhe llojllojshmërisë së detyrave të punës.
 - 1.3 Shkathësitë – përcaktojnë nivelin e aftësive që nevojiten për vendin e caktuar të punës.
 - 1.4 Kualifikimet – përcakton nivelin e arsimit, trajnimeve dhe njohurive përkatëse për ushtrimin e detyrave të vendit të punës.





1.5 Përvoja profesionale – përcakton përvojën e punës, në nivelin dhe detyra të përafërta profesionale.

2 Në total janë 22 grada:

	Grada	Vlera në Euro
2.1	ASHNA 1A	€ 520.00
2.2	ASHNA 1B	€ 572.00
2.3	ASHNA 1C	€ 598.00
2.4	ASHNA 2	€ 650.00
2.5	ASHNA 2A	€ 676.00
2.6	ASHNA 2B	€ 728.00
2.7	ASHNA 2C	€ 780.00
2.8	ASHNA 3	€ 832.00
2.9	ASHNA 3A	€ 884.00
2.10	ASHNA 3B	€ 936.00
2.11	ASHNA 3C	€ 988.00
2.12	ASHNA 4	€ 1,040.00
2.13	ASHNA 4A	€ 1,092.00
2.14	ASHNA 4B	€ 1,196.00
2.15	ASHNA 4C	€ 1,352.00
2.16	ASHNA 5	€ 1,508.00
2.17	ASHNA 5A	€ 1,664.00
2.18	ASHNA 5B	€ 1,872.00
2.19	ASHNA 5C	€ 1,976.00
2.20	ASHNA 6	€ 2,028.00
2.21	ASHNA 6A	€ 2,132.00
2.22	ASHNA 6B	€ 2,288.00

Neni 11

Planifikimi i punës

1. ASHNA duke iu përgjigjur ligjeve dhe rregullave pozitive si organizatë buxhetore, planifikimin e punës e bën në bazë vjetore me mundësi rishikimi – përkatësisht, në fund të vitit kalendarik për vitin që vijon.
2. Përgatitja e planit të punës dhe realizimi i saj, konsiston në përgatitjen disa dokumenteve dhe aprovimin e tyre nga Drejtori:
 - 2.1 **Manualet e Departamenteve**, rishikohen në baza vjetore.
 - 2.2 **Raporti Vjetor**.
Ligji Nr. 04/L-250 - për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Neni 5, pika 9; Neni 18.
 - 2.3 **Plani vjetor i punës**.





- 2.4 **Vetë-vlerësimi i Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.**
Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.5 **Raport për Kenaqesine e Konsumatorit**, në baza vjetore.
Ligjin Nr. 04/L-250 - për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Neni 16, Par. 1.8; 1.12 dhe 1.13.
- 2.6 **Buletini i Kontrollit të Trafikut Ajror.**
Manualit për Buletinin e ASHNA-së.
- 2.7 **Kosto bazë e tarifës terminale dhe numri i parashikuar i njësive të shërbimeve terminale për zonën tarifore terminale**, dorëzimi fillestar para aprovimit të KASH-it dhe dorëzimi përfundimtar para dëgjimeve buxhetore në MF.
Rregullorja 03/2016 Mbi Përcaktimin e Skemës së përbashkët të Tarifave për Shërbimet e Navigacionit Ajror.
- 2.8 **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve**, për planifikimin buxhetor dhe parashikimet për dy vitet e ardhshme.
Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.9 **Buxhetit final**, pas pranimit të kufijve buxhetor final nga Ministria e Financave.
Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.10 **Propozim Plani i Rrjedhës së Parasë**, për alokim të fondeve sipas aprovimit të buxhetit.
Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.11 **Përgatitja e kërkesës për rishikim buxhetor**, sipas nevojës.
Ligji Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.12 **Plani i Biznesit 5 vjeçar.**
Rregullorja 07/2012 AACK-së Anex 1.
- 2.13 **Plani vjetor i Biznesit.**
Rregullorja 07/2012 AACK-se Anex 1; Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
- 2.14 **Raporti vjetor financiar**, për përfundimin e vitit fiskal.
Rregullorja MF-Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.
- 2.15 **Planifikimi paraprak i prokurimit.**
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Kreu III, Neni 8, Pika 1.
- 2.16 **Planifikimi përfundimtar i prokurimit.**
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, Kreu III, Neni 8, Pika 1.
- 2.17 **Raporti vjetor për kontratat publike të nënshkruara.**
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 17, pika 17.3.
- 2.18 **Plani vjetor i Trajnimeve.**
Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Rregullore 05-2012 Rregullat për Licencën e Kontrollorëve të Trafikut Ajror dhe Certifikimet tjera; Rregullore 12-2010 Certifikimi i Ofruesit të Shërbimeve të Navigimit Ajror; Manuali i Departamentit DZHT.
- 2.19 **Plani 3 vjeçar i Trajnimeve.**
- 2.20 **Rregullore për orarin operativ**, rishikohet në baza vjetore.
- 2.21 **Planin e Personelit**, në bazë vjetore.
Rregullore Nr. 02/2014 për Planifikimin e Personelit në Shërbimin Civil.
- 2.22 **Plani orientues i pushimeve vjetore**, në bazë vjetore.
Rregullore Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil.
- 2.23 **Raporti për përcaktimin e objektivave të personelit**, në bazë vjetore.
Rregullore Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil.





- 2.24 **Raporti i vlerësimit të rezultateve të personelit**, në bazë vjetore.
Rregullore Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil.
 - 2.25 **Përmbledhja Klimatologjike e Aerodromit**.
ICAO Annex-in 3, kapitullin 8; ICAO Annex-in 14, Volumi 1 dhe WMO Doc 100.
 - 2.26 **Plani vjetor i publikimeve në AIP**.
Manuali i Departamentit AIS.
 - 2.27 **Plani vjetor i Auditit të Cilësisë**.
AAC Rregullorja 07/2012.
 - 2.28 **Plani vjetor i Auditit të Sigurisë**.
AAC Rregullorja 07/2012, Rreg. 1/2013 mbi Zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS), Rreg. Nr. 6/2012 PËR Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe Shërbimet e Navigacionit Ajror.
 - 2.29 **Plani vjetor I Anketimeve të Sigurisë**.
AAC Rregullorja 07/2012, Rreg. 1/2013 mbi Zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS), Rreg. Nr. 6/2012 PËR Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe Shërbimet e Navigacionit Ajror.
 - 2.30 **Buletini i Sigurisë**, çdo 3 muaj.
AAC Rregullorja 07/2012, Rreg. 1/2013 mbi Zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS), Rreg. Nr. 6/2012 PËR Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe Shërbimet e Navigacionit Ajror.
 - 2.31 **Plani 3 vjeçar i auditimit të brendshëm**.
 - 2.32 **Plani vjetor i auditimit të brendshëm**.
 - 2.33 **Rishikimi i procedurave instrumentale të fluturimit**.
PANS OPS 8168 V2
 - 2.34 **Menaxhimi i riskut në ASHNA**.
Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë, nr.04/L-161.
3. Departamentet dhe menaxherët e tyre obligohen të bashkëpunojnë në përgatitjen e këtyre dokumenteve.

Neni 12 Raportimi

1. Raportimi në ASHNA konsiston në raport hierarkik e që merr formë finale atëherë kur Drejtori i ASHNA-së përmbledh raportet e zëvendësdrejtorëve, menaxherëve të departamenteve dhe divizioneve përkatëse.
2. Brenda 10 ditëve pas përfundimit të muajit kalendarik Zëvendësdrejtorët, Menaxheret e Departamenteve dhe njesitë përkatëse janë të obliguar që të dorëzojnë raportet mujore tek Zyra e Drejtorit.
3. Raportet Mujore pasqyrojnë aktivitet mujore, ndryshimet eventuale, përshkruhen veprimet e marra, rezultatet e arritura si dhe efektshmëria dhe performanca e përgjithshme në realizimin e objektivave të përcaktuara.
4. Raporti Vjetor konsiston në vitin kalendarik (Janar-Dhjetor).
5. 45 ditë pas përfundimit të vitit kalendarik ASHNA përmbledh raportet e punës nga Zëvendësdrejtorët dhe Menaxheret e Departamenteve apo njesive caktuara, në një dokument të vetëm unik: Raporti Vjetor.
6. Në përputhje me Ligjin mbi ASHNA 04-L/250 Neni 18.2 ASHNA dorëzon raportin vjetor për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës, deri më datën 31, të muajit Mars, të vitit pasues.
7. Mbledhjet dhe takimet e rregullta të menaxhmentit, komiteteve apo grupeve punuese do të rregullohet me një akt të veçantë.





Neni 13

Buxheti i ASHNA

1. Për çdo vit fiskal Drejtori përgatit propozim-kërkesën për buxhet dhe alokime për ASHNA dhe i dorëzon Ministrin të Financave. Përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve të tilla e bën në pajtim me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke marrë parasysh nivelin e shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara si dhe të hyrave të dedikuara të ASHNA-së.
2. ASHNA grumbullon të hyra nga shërbimet që u ofrohen fluturakeve, për të cilat tarifat përcaktohen me Rregulloren 3/2016 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (më tej AACK).
3. Bazuar në Nenin 11 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ASHNA mund të grumbullojë të hyra edhe nga donacionet, grantet apo mbështetje tjetër financiare dhe teknike.

Neni 14

Titujt e vendeve të punës

1. Lista e titujve të vendeve të punës në ASHNA, konsiston në 125 tituj të niveleve të ndryshme hierarkike por të njejtës familje të vendeve të punës – Navigacioni Ajror.

Nr.	Titujt e vendeve të punës	Grada
1	Drejtor	
2	Zëvendësdrejtor për shërbime operative	
3	Zëvendësdrejtor për shërbime administrative financiare	
4	Menaxher i Departamentit për Cilësi, Siguri dhe Sigurim	ASHNA 6B
5	Menaxher i Departamentit të Shërbimeve të Trafikut Ajror	ASHNA 6B
6	Menaxher i Zyrës së Drejtorit	ASHNA 6A
7	Menaxher i Departamenti Teknik	ASHNA 6A
8	Udhëheqës i Divizionit Vajtje/Ardhje	ASHNA 6A
9	Udhëheqës i Divizionit të Kullë	ASHNA 6A
10	Mbikëqyrës i Ndërrimit të Njësive Vajtje/Ardhje dhe Kullë	ASHNA 6
11	Planifikues Vajtje/Ardhje	ASHNA 6
12	Koordinator për marrëdhënie me jashtë	ASHNA 5C
13	Menaxher i Departamentit për Zhvillim dhe Trajnim	ASHNA 5C
14	Koordinator për Kërkim-Shpëtim	ASHNA 5C
15	Kontrollor i Trafikut Ajror (Kullë)	ASHNA 5B
16	Kontrollor i Trafikut Ajror (Lëvizje Tokësore)	ASHNA 5B
17	Kontrollor i Trafikut Ajror (Vajtje/Ardhje)	ASHNA 5B
18	Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	ASHNA 5A
19	Menaxher i Departamentit të Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	ASHNA 5A
20	Menaxher i Departamentit Meteorologjik	ASHNA 5A
21	Këshilltar Ligjor i Aviacionit Civil	ASHNA 5
22	Këshilltar Ekonomiko-Financiar i Aviacionit Civil	ASHNA 5



R.M.



23	Zëvendës Menaxher i Departamenti Teknik për KNV	ASHNA 5
24	Zëvendës Menaxher i Departamenti Teknik për Automatizim dhe Mirëmbajtje	ASHNA 5
25	Menaxher i Departamentit të Prokurimit	ASHNA 4C
26	Menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore	ASHNA 4C
27	Menaxher i Departamentit të Financave	ASHNA 4C
28	Menaxher i Departamentit të Administratës	ASHNA 4C
29	Menaxher i Departamentit Ligjor	ASHNA 4C
30	Udhëheqës i Divizionit të Sigurisë	ASHNA 4B
31	Udhëheqës i Divizionit të Cilësisë dhe Perputshmërisë	ASHNA 4B
32	Udhëheqës i Divizionit të Sigurimit	ASHNA 4B
33	Udhëheqës i Divizionit të Komunikimit	ASHNA 4B
34	Udhëheqës i Divizionit të Navigimit	ASHNA 4B
35	Udhëheqës i Divizionit të Survejimit	ASHNA 4B
36	Udhëheqës i Divizionit të Procesimit	ASHNA 4B
37	Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informatike	ASHNA 4B
38	Udhëheqës i Divizionit të Mirëmbajtjes së Lokacioneve	ASHNA 4B
39	Udhëheqës i Divizionit për Trajnime	ASHNA 4B
40	Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim	ASHNA 4B
41	Mbikqyrës i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	ASHNA 4B
42	Udhëheqës i Divizionit të Parashikimit	ASHNA 4B
43	Udhëheqës i Divizionit për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike	ASHNA 4B
44	Zëdhënës i ASHNA-së	ASHNA 4A
45	Ekspert i Sigurisë	ASHNA 4A
46	Zyrtar Çertifikues /Aprovues	ASHNA 4
47	Sekretar i Komitetit për Buxhet, Cilesi dhe Siguri	ASHNA 4
48	Specialist i Divizionit të Komunikimeve	ASHNA 4
49	Specialist i Divizionit të Navigimit	ASHNA 4
50	Specialist i Divizionit të Survejimit	ASHNA 4
51	Specialist i Divizionit të Procesimit	ASHNA 4
52	Udhëheqës i Sektorit për Rrymë, Klimatizim dhe Gjeneratorë	ASHNA 4
53	Udhëheqës i Mirëmbajtjes	ASHNA 4
54	Mbikqyrës i Zyrës për Publikimin e Informatave Aeronautike	ASHNA 4
55	Parashikues Meteorologjik Aeronautik	ASHNA 4
56	Udhëheqës i Divizionit të Vrojtimit	ASHNA 4
57	Zyrtar i lartë Ligjor	ASHNA 4
58	Inxhinier i Divizionit të Komunikimeve	ASHNA 3B
59	Inxhinier i Divizionit të Navigimit	ASHNA 3B
60	Inxhinier i Divizionit të Survejimit	ASHNA 3B





61	Inxhinier i Divizionit të Procesimit	ASHNA 3B
62	Teknik udhëheqës ndërrimi i komunikimeve	ASHNA 3B
63	Teknik udhëheqës ndërrimi i Navigimit	ASHNA 3B
64	Teknik udhëheqës ndërrimi i Survejimit	ASHNA 3B
65	Teknik udhëheqës ndërrimi i Procesimit	ASHNA 3B
66	Përgjegjës i Workshopit	ASHNA 3B
67	Zyrtar për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike	ASHNA 3B
68	Mbikqyrës i Dhomës së Monitorimit të Kamerave	ASHNA 3A
69	Teknik i Divizionit të Komunikimeve	ASHNA 3A
70	Teknik i Divizionit të Navigimit	ASHNA 3A
71	Teknik i Divizionit të Survejimit	ASHNA 3A
72	Teknik i Divizionit të Procesimit	ASHNA 3A
73	Administrator i Sistemeve të Divizionit të Teknologjise Informative	ASHNA 3A
74	Administrator i Rrjetit të Divizionit të Teknologjise Informative	ASHNA 3A
75	Administrator i Sistemeve të Sigurisë të Divizionit të Teknologjise Informative	ASHNA 3A
76	Teknik për Rrymë dhe Klimatizim	ASHNA 3A
77	Teknik për Rrymë dhe Gjeneratorë	ASHNA 3A
78	Zyrtar i Prokurimit	ASHNA 3A
79	Udhëheqës i Sektorit të Personelit	ASHNA 3A
80	Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Shëndet në Punë	ASHNA 3A
81	Zyrtar i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	ASHNA 3A
82	Zyrtar i Statistikave dhe Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	ASHNA 3A
83	Vrojtes Meteorologjik Aeronautik	ASHNA 3A
84	Udhëheqës i Sektorit të Pasurisë	ASHNA 3A
85	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta	ASHNA 3A
86	Zyrtar i Divizionit të Cilësisë dhe Perputhshmërisë	ASHNA 3
87	Zyrtar i Personelit	ASHNA 3
88	Zyrtar i Pagave	ASHNA 3
89	Zyrtar për Siguri dhe Shëndet në Punë	ASHNA 3
90	Zyrtar i tarifave	ASHNA 3
91	Zyrtar Shpenzues	ASHNA 3
92	Zyrtar Zotues	ASHNA 3
93	Zyrtar i të hyrave	ASHNA 3
94	Zyrtar i pasurisë	ASHNA 3
95	Zyrtar i Pasurisë	ASHNA 3
96	Zyrtar i Transportit	ASHNA 3
97	Përkthyes Shqip-Anglisht-Shqip; Shqip-Serbisht-Shqip	ASHNA 3
98	Zyrtar Ligjor	ASHNA 3






99	Teknik i Mirëmbajtjes	ASHNA 2C
100	Arkivist	ASHNA 2C
101	Asistent i Drejtorit	ASHNA 2B
102	Arkëtar	ASHNA 2B
103	Asistent i Prokurimit	ASHNA 2A
104	Asistent për Siguri dhe Shëndet në Punë	ASHNA 2A
105	Asistent i Zëvendës drejtorit për shërbime operative	ASHNA 2A
106	Asistent i Zëvendës drejtorit për shërbime administrative financiare	ASHNA 2A
107	Asistent Administrativ Financiar	ASHNA 2A
108	Depoist	ASHNA 2A
109	Mbikqyrës i Ndërrimit të Sigurimit	ASHNA 2
110	Personel i Sigurimit	ASHNA 1C
111	Personel i Radioskopit	ASHNA 1C
112	Shofer i Drejtorit	ASHNA 1B
113	Shofer i Zëvendës drejtorit për shërbime operative	ASHNA 1B
114	Shofer i Zëvendës drejtorit për shërbime administrative financiare	ASHNA 1B
115	Shofer	ASHNA 1B
116	Student Kontrollor i Trafikut Ajror	ASHNA 1A
117	Student i Shërbimeve të Informacionit Aeronautik	ASHNA 1A
118	Student Parashikues Meteorologjik Aeronautik	ASHNA 1A
119	Student Vrojtues Meteorologjik Aeronautik	ASHNA 1A
120	Nikoqir	ASHNA 1A
121	Pastruese	ASHNA 1A
122	Vlerësuesi i Kompetencës së Kontrollorëve	
123	Udhëheqës Instruktor	
124	Instruktor Kontrollor	
125	Përgjegjës i dhomës së monitorimit	





KREU III
PËRSHKRIMET PËR POZITAT NË ASHNA

Neni 15
Drejtori i ASHNA-së dhe Zyra e Drejtorit





1. Titulli i vendit të punës		Drejtor	
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	
4. Qëllimi i vendit të punës			
• Ligji nr. 04/l-250 për agjencinë e shërbimet të navigacionit ajror			
5. Detyrat kryesore:			
<ol style="list-style-type: none">Drejtori prioritet të madh i kushton ruajtjes së sigurisë të navigacionit ajror dhe siguron ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të ASHNA-s në pajtim me legjislacionin në fuqi.Drejtori mbikëqyr të gjitha çështjet e sigurisë, teknike operative, administrative, financiare dhe ligjore, të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me menaxhimin dhe operimin e ASHNA-s dhe me pronat e saj.Drejtori përfaqëson ASHNA-n në projektet dhe iniciativat vendore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me aktivitetet e saj.Drejtori siguron që aktivitetet e ASHNA-s të jenë në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike si dhe Përgjegjësitë dhe me ligjet tjera relevante.			
6. Kualifikimet dhe shkathësitë e kërkuara			
<ol style="list-style-type: none">Të këtë diplomë universitare nga një institucion i akredituar akademik, apo një gradë pasuniversitare në fushën e aviacionit civil.Të këtë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në menaxhim në fushën e Aviacionit civil apo navigacionit ajror.Të mos këtë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale.Të mos këtë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë monetar, financiar ose interes tjetër në ndonjë organizatë biznesore që është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil.			



P.M.



1. Titulli i vendit të punës	Këshilltar Ligjor i Aviacionit Civil		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 5
4. Qëllimi i vendit të punës	Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe këshillimit për Drejtorin e ASHNA-së në fushën ligjore të aviacionit civil.		
5. Detyrat kryesore:	<ol style="list-style-type: none">1. Këshillon Drejtorin e ASHNA-së për çdo veprim, që nxitë ndryshime të rregullativës. 20%2. Ndjekë aktet juridike të Republikës së Kosovës, që ndërlihen me aviacionin civil. 15%3. Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme për Drejtorin e ASHNA-së. 15%4. Këshillon dhe rekomandon Drejtorin mbi hartimin dhe implementimin e politikave. 15%5. Propozon plotësim/ndryshime të rregullativës së ASHNA-së dhe që ndërlihen me të. 10%6. Jep këshilla mbi zbatimin efikas të proceseve zhvillimore. 10%7. Mbështet personelin ligjor të ASHNA-së sipas nevoje. 10%8. Kryen edhe detyra tjera me kërkesë të Drejtorit. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathësitë e kërkuara	<ol style="list-style-type: none">1. Aftësi komunikuese.2. Njohuri të avancuara dhe ekspertizë në fushën e aviacionit civil.3. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.4. Shkathësi në planifikim të punës dhe analizë.5. Shkathësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).6. Diplomë universitare në Fakultetin Juridik, 5 vit përvojë pune profesionale.		





1. Titulli i vendit të punës	Këshilltar Ekonomiko-Financiar i Aviacionit Civil		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 5
4. Qëllimi i vendit të punës	Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe këshillimit për Drejtorin e ASHNA-së në fushën financiare të aviacionit civil.		
5. Detyrat kryesore:	<ol style="list-style-type: none">1. Këshillon Drejtorin e ASHNA-së për çdo veprim, që afekton në aspektin financiar. 20%2. Këshillon në përpilimin e politikave financiare dhe buxhetore. 15%3. Drafton opinione/memorandume/përmbledhje profesionale financiare në çështje të ndryshme për Drejtorin e ASHNA-së. 15%4. Këshillon dhe rekomandon Drejtorin mbi hartimin dhe implementimin e politikave. 15%5. Propozon plotësim/ndryshime të rregullativës së ASHNA-së dhe që ndërliken me të. 10%6. Jep këshilla mbi zbatimin efikas të proceseve zhvillimore. 10%7. Mbështet personelin financiar të ASHNA-së sipas nevojë. 10%8. Kryen edhe detyra tjera me kërkesë të Drejtorit. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathësitë e kërkuara	<ol style="list-style-type: none">1. Aftësi komunikuese.2. Njohuri të avancuara dhe ekspertizë në fushën e aviacionit civil.3. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.4. Shkathësi në planifikim të punës dhe analizë.5. Shkathësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).6. Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik, 5 vit përvojë pune profesionale.		



P.M.



1. Titulli i vendit të punës	Asistent i Drejtorit		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 2B
4. Qëllimi i vendit të punës	Ofrimi i përkrahjes administrative dhe teknike për Drejtorin e ASHNA-së		
5. Detyrat kryesore:	<ol style="list-style-type: none">1. Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimë dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme. 20%2. Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin. 15%3. Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj. 15%4. Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit. 15%5. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik; 10%6. Mban regjistër të saktë dhe të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, etj, përfshirë përgatitjen e raporteve dhe analizave statistikore. 10%7. Mban kontakte të rregullta me punonjësit në të gjitha nivelet e institucionit, stafin e institucioneve tjera dhe publikun, përfshirë ofrimin e ndihmës dhe këshillave e udhëzimeve për çështje të caktuara ose shkëmbim të informatave. 10%8. Organizon udhëtimet e Drejtorit, përfshirë përgatitjen e formularëve adekuat për udhëtim marrjen e vizave, rezervimet e hotelit, transportin lokal dhe përcjelljen e dokumenteve relevante, dhe bënë përmbledhjen e raporteve adekuate konform rregullave dhe procedurave të parapara me aktet e brendshme. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara	<ol style="list-style-type: none">1. Aftësi komunikuese.2. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.3. Shkathtësi në planifikim të punës dhe analizë.4. Shkathtësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).5. Diplomë universitare, 1 vit përvojë pune profesionale.		





1. Titulli i vendit të punës	Shofer i Drejtorit		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 1B
4. Qëllimi i vendit të punës	Ofrimi i përkrahjes administrative dhe teknike për Drejtorin e ASHNA-së		
5. Detyrat kryesore:	<ol style="list-style-type: none">1. Ofron shërbime të vozitjes për Drejtorin e ASHNA-së. 20%2. Siguron që automjeti të jetë i pastër dhe në gjendje të mirë. 15%3. Përgjigjet në mënyrë të shpejtë kërkesave për mbështetje në vozitje për detyra zyrtare. 15%4. Mbanë të dhënat për përdorimin e automjeteve të institucionit dhe përgatitë dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre. 15%5. Duhet të jetë në gjendje që të kryejë riparime të vogla. 10%6. Duhet të jetë në dispozicion për vizita zyrtare. 10%7. Kryen funksione rutinore të korrierit me kërkesë të Drejtorit të ASHNA-së. 10%8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga Drejtori. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathësitë e kërkuara	<ol style="list-style-type: none">1. Aftësi komunikuese.2. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri elementare të gjuhës angleze.3. Shkathësi në planifikim të punës.4. Patent shofer valid të kategorisë "B".5. Shkathësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).6. Shkollim i mesëm, 2 vit përvojë pune profesionale.		



P.M.



1. Titulli i vendit të punës	Menaxher i Zyrës së Drejtorit		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 6A
4. Qëllimi i vendit të punës	Të siguroj mbarëvajtjen e shërbimeve përkrahëse në Zyrën e Drejtorit.		
5. Detyrat kryesore:	<ol style="list-style-type: none">Të siguroj zbatimin e vendimeve, urdhëresave dhe udhëzimeve të Drejtorit. 20%Të këshilloj dhe siguroj këshilla për Drejtorin për aktet administrative juridike që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe të kujdeset për korrespondencën e Drejtorit. 15%Të kujdeset për organizimin, përgatitjen, protokolimin e mbledhjeve dhe të takimeve që drejtohen nga Drejtori, personalisht ose në emër të tij. 15%Të kujdeset për trajtimin e çështjeve konkrete, të cilat i përcillen për shqyrtim nga ana e Drejtorit dhe raportimin para tij për përfundimin apo për probleme që lidhen me procesin e shqyrtimit të tyre. 15%Të merret me përmblidhjen e informacionit javor apo mujor të marrë nga zyrtarët përkatës. 10%Të bëjë shqyrtimin e problemeve të ngritura në kërkesat apo ankesat. 10%Të bëjë koordinimin brenda atributëve të dhëna, të raporteve me institucionet shtetërore, zyrtat homologe dhe institucione të tjera ndërkombëtare të aviacionit civil. 10%Të kujdeset për zbatimin e protokollit zyrtar gjatë mbledhjeve dhe takimeve që drejtohen nga Drejtori i ASHNA-së. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathësitë e kërkuara	<ol style="list-style-type: none">Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim.Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.Shkathësi në udhëheqje, organizim të ekipit, caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.Shkathësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).Diplomë universitare, 5 vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku 2 vite në pozitë drejtuese.		





1. Titulli i vendit të punës		Zyrtar Çertifikues/Aprovues	
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	
		ASHNA 4	
4. Qëllimi i vendit të punës			
Sigurimi se shpenzimi i parasë publike për çdo aktivitet të institucionit të bëhet në harmoni me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe procedurave tjera nga kjo lëmi.			
5. Detyrat kryesore:			
<ol style="list-style-type: none">Në pajtim me mbikëqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit/ sektorit dhe jep rekomandime lidhur me objektivat e njësisë. 20%Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën profesionale specifike si dhe ndihmon stafin vartës në ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre. 15%Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të divizionit dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kurohet. 15%Certifikon realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore të institucionit. 15%Siguron që kushtet e zbatueshmërisë të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. 10%Siguron që shpenzimi i parasë publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF, dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik. 10%Siguron që janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa, dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve. 10%Siguron që rregullat e KBFP dhe dispozitat tjera ligjore janë respektuar gjatë inicimit dhe realizimit të aktivitetit të prokurimit dhe procedimit të shpenzimeve. 5%			
6. Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara			
<ol style="list-style-type: none">Aftësi komunikuese.Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.Shkathtësi në planifikim të punës dhe analizë.Shkathtësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).Diplomë universitare, 3 vite përvojë pune profesionale.			



P.M.



1. Titulli i vendit të punës	Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm	
2. Kodi për pozitën përkatëse	3. Grada e vendit të punës	ASHNA 5A
4. Qëllimi i vendit të punës		
Zhvillon dhe menaxhon zbatimin e planit të auditimit të brendshëm për të siguruar përdorim produktiv, ekonomik dhe efikas të resurseve të institucionit dhe siguron zbatimin dhe respektimin e saktë të të gjitha ligjeve, rregullave, politikave dhe udhëzimeve.		
5. Detyrat kryesore:		
<ol style="list-style-type: none">1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të njësisë dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave. 20%2. Menaxhon me stafin e njësisë dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore. 15%3. Siguron përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të planeve të parapara me nenin 5.2 të Ligjit për Auditim të Brendshëm. 15%4. Ndan punën tek auditorët në përputhje me Planin për Auditim dhe monitoron zbatimin, ofron inpute dhe këshilla profesionale sipas kërkesës. 15%5. Përgatit raportin e auditimit për njësinë organizative që është duke u audituar, përfshirë rekomandimet për njësinë. 10%6. Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga institucioni dhe njësitë organizative dhe inicion veprime korrigjuese aty ku është e nevojshme. 10%7. Përgatit dhe dorëzon raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit tek udhëheqësi i institucionit dhe Komisioni për Auditim të Brendshëm i organizatës. 10%8. Bën vlerësim të rregullt të punës së stafit dhe këshillon udhëheqësin rreth nevojave për trajnim në fushën e sektorit të gjendjes civile. 5%		
6. Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara		
<ol style="list-style-type: none">1. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim.2. Përveç gjuhës zyrtare të Kosovës, të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze.3. Shkathtësi në udhëheqje, organizim të ekipit, caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.4. Shkathtësi kompjuterike në programet (Word, Excel, Power Point, Access).5. Diplomë universitare, 5 vite përvojë pune profesionale.		



P.M.



1. Titulli i vendit të punës	Kordinator për marrëdhënie me jashtë		
2. Kodi për pozitën përkatëse		3. Grada e vendit të punës	ASHNA 5C
4. Qëllimi i vendit të punës	Të siguroj bashkëpunim profesional me ANSP në rajon dhe botë dhe organizatat tjera ndërkombëtare profesionale, si dhe reprezentim pozitiv të ASHNA-së.		
